



RAPORT I DALË NGA SEANCA DËGJIMORE ME MOSTRËN PËRFAQËSUESE TË STUDENTËVE

Menaxherja për Sigurimin e Cilësisë së Kolegjit ESLG më datën 02.04.2021 ka mbajtur një seancë dëgjimore me mostrën përfaqësuese të studentëve të nivelit Master në programin Menaxhimi i Patundshmërive dhe Infrastrukturës. Qëllimi i kësaj séance është që të ngritet cilësia e mbrendshme e mësimdhënies në kuadër të programit. Në këtë seancë është përzgjedhur mostra në mes të studentëve me arritje të larta dhe atyre me arritje të ulëta. Kolegji ESLG aplikon senaca dëgjimore në vazhdimësi prej vitit në vit për të identifikuar praktikatat e mira të mësimnxënies tek studentët me arritje të larta, duke i transferuar këto praktika tek studentët me arritje të ulëta. Si objektiv tjetër e seancës dëgjimore është që të identifikohen vështirësitë dhe sfidat me të cilat hasin studentët gjatë studimeve, e veçanërisht studentët që kanë arritur më pak rezultate, pastaj gjetja e metodave më të përshtatshme të mësimdhënies për të përkrahur studentët me të arritje të ulëta.

TË GJEURAT

Opinionet e dhëna nga studentët me të arritura të larta janë paraqitur si në vijim;

- Studentëve iu është ofruar metodë e shkëlqyeshme e mësimdhënies;
- Qasja profesorë- studentë është e lartë;
- Ofrimi i ushtrimeve dhe shembujve praktik është në nivel të duhur;
- Interaksioni mes studentëve dhe ligjëruesve gjithashtu është i lartë.
- Qasja e ligjerimit në formën online është e mirë dhe e qasshme;
- Studentëve iu është ofruar material i duhur për lëndët përkatëse.
- Organizim i orarit është efikas (jo i ngjeshur).

Si konkludim, responentët kanë shprehur mendimin e tyre konstruktiv, duke potencuar që në të ardhmën të iu ofrohen më shumë shembuj me video, duke marrë shembull njërin nga ligjëruesit i cili e praktikon këtë metodë në vazhdimësi. Gjithashtu, responentët kanë dhënë mendimin e tyre kritik që në të ardhmën ligjeratat në njërin nga lëndët të kombinohen me më shumë shembuj praktik. Responentët propozojnë që të ofrohet stimulim më i lartë i bashkëbisedimit, duke e veçuar në këtë rast formën online të ligjerimit. Andaj, analizuar nga këndvështrimi i përgjithshëm,

respondentët mendojnë që arritja e rezultateve të tyre nuk qëndron vetëm falë përkushtimit dhe angazhimit të tyre, por më shumë falë cilësisë së lartë të mësimdhënies.

Opinionet e dhëna nga studentët me të arritura të ulëta janë paraqitur si në vijim;

- Metoda e ligjerimit është në nivel;
- Studenteve iu janë ofruar shembuj të mjaftueshëm praktik;
- Qasja e ligjëruesve është e lartë;

Se pse kanë ngecur dhe nuk kanë arritur rezultatet të kënaqshme në krahasim me studentët e tjerë është veçuar forma e ligjerimit online dhe mos-përputhja e orarit të punës me kohën e ligjeratave.

REKOMANDIME

- Përfshirja e më shumë rasteve studimore në njërën nga lëndët;
- Stimulim më i lartë i bashkëbisedimit për shkak të formës online të mësimdhënies;
- Kombinim i ligjeratave online dhe fizikisht 50% me 50%.
- Rritja e interesit të studentëve në ligjëratat veçanërisht online nëpërmjet të videove, dokumentareve, mini kuizeve në mënyrë që të zgjohet kureshtja e studentëve gjatë ligjëratave online;
- Ngritja e debateve dhe diskutimeve, duke e ngritur një pyetje diskutuese;
- Ngritja e nivelit të lirisë së shprehjes akademike (duke iu dhënë mundësinë studentëve që të ofrojnë shembuj praktik nga përvoja e tyre;

Hoxha

M.S.c Jehona Hoxha

